



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 9 korrik 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit  
për Ndryshim të Vendimit KSC-BC-2020-06/F00386**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në përputhje me nenin 53 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 56(5) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 5 nëntor 2020, në vijim të konfirmimit të Aktakuzës,<sup>2</sup> Kadri Veseli ("z. Veseli") u arrestua në përputhje me vendimin dhe fletarrestimin e lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.<sup>3</sup>

2. Më 2 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e mbajtjes në paraburgim të z. Veseli.<sup>4</sup>

3. Më 8 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori një vendim për miratimin, për arsye humanitare, të një vizite të z. Veseli si i paraburgosur, në varësi të zbatimit të një numri kushtesh ("Vendimi për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur").<sup>5</sup>

4. Më 9 korrik 2021, z. Veseli dorëzoi një kërkesë urgjente për ndryshimin e kushteve të përcaktuara në Vendimin për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, publik; F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë e Rishikuar më tej*, 4 nëntor 2020, publike.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-06, F00050, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Kadri Veselit sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik; F00027/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi*, 26 tetor 2020, publik; F00027/A03/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për Kadri Veselin*, 26 tetor 2020, publik.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, F00380, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Kadri Veselit*, 2 korrik 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u nxor në të njëjtën datë, F00380/RED.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-06, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, F00386, *Vendim i Dytë mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Lirim të Përkohshëm për Arsye Humanitare*, 8 korrik 2021, konfidencial dhe *ex parte*.

(“Kërkesa”)<sup>6</sup>, duke kërkuar që: (i) të lejohej të vizitonte varrin e babait të tij të ndjerë, sipas diskrecionit të oficerëve të rojës;<sup>7</sup> (ii) të lejohej të shoqërohej [REDAKTUAR] me persona të tjerë jashtë familjes së ngushtë, përkatësisht me të afërm të rrethit të dytë.<sup>8</sup>

5. Në të njëjtën datë, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) iu përgjigj Kërkesës (“Përgjigja”).<sup>9</sup> ZPS-ja nuk e kundërshtoi kërkesën e z. Veseli për të vizituar varrin e babait të tij të ndjerë, në varësi të vazhdimit të zbatimit të kushteve të përcaktuara në Vendimin për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur.<sup>10</sup> Nga ana tjetër, ZPS-ja kundërshtoi kërkesën e z. Veseli për të zgjeruar listën e personave të autorizuar me të cilët ai mund të shoqërohej [REDAKTUAR], për faktin se, sipas ZPS-së, një tubim i tillë i madh personash do të rriste ndjeshëm rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b), duke penguar aftësinë për të monitoruar në mënyrë efikase ndërveprimet e tyre.<sup>11</sup>

6. Administratorja gjithashtu dorëzoi parashtrime në lidhje me kërkesën në të njëjtën datë (“Parashtrimet e Zyrës Administrative”).<sup>12</sup> Megjithëse vuri në dukje se varri [REDAKTUAR] dhe se vizita e z. Veseli mund të shkaktonte praninë e mediave, Administratorja gjykoi se ishte e mundur të realizohej një vizitë e vetme dhe për një kohë të kufizuar tek varri.<sup>13</sup> Administratorja më tej propozoi disa kushte të veçanta për kryerjen e kësaj vizite dhe kërkoi zbatimin e kushtit të ruajtjes së fshehtësisë të përcaktuar në Vendimin për Miratimin e Vizitës si i

---

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-06, Mbrojtja e z. Veseli, *Kërkesë Urgjente e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshim të Vendimit KSC-BC-2020-06/F00386*, 9 korrik 2021, konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcën 1, konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>7</sup> Kërkesa, para. 5-8.

<sup>8</sup> Kërkesa, para. 9-10.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-06, F00389, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje Urgjente e Prokurorisë ndaj Kërkesës Urgjente të Mbrojtjes së Veselit për Ndryshim të Vendimit*, 9 korrik 2021, konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>10</sup> Përgjigja, para. 2.

<sup>11</sup> Përgjigja, para. 3.

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-06, F00390, Administratorja, *Parashtrime të Administratores mbi Kërkesën Urgjente të Mbrojtjes së Veselit për Ndryshim të Vendimit KSC-BC-2020-06/F00386*, 9 korrik 2021, konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>13</sup> Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 4.

Paraburgosur edhe për vizitën tek varri.<sup>14</sup> Sa i përket zgjerimit të kërkuar të grupit të personave me të cilët zotit Veseli i lejohej të shoqërohej [REDAKTUAR], Administratorja e kundërshtoi këtë, duke vënë në dukje një sërë shqetësimesh logjistike dhe të sigurisë.<sup>15</sup> Gjithashtu, Administratorja parashtroi se organizimi i vizitave për 13 persona në objektin e sigurt të transferimit nuk do të ishte e mundshme të realizohej as nga pikëpamja logjistike e as nga ajo e sigurisë.<sup>16</sup> Së fundi, Administratorja rikujtoi se Zyra Administrative nuk kishte marrë ende emrat e të gjithë anëtarëve të familjes së ngushtë për të marrë miratimin paraprak të përgjegjësit të rojave.<sup>17</sup>

7. Mbrojtja u kundërpërgjigj në të njëjtën ditë (“Kundërpërgjigjja”)<sup>18</sup>. Megjithëse falënderoi Zyrën Administrative për mundësimin e vizitës si i paraburgosur dhe miratimin e vizitës tek varri,<sup>19</sup> Mbrojtja i kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake që çështjen e vizitave të të afërmeve të rrethit të dytë t’ia linte diskrecionit të përgjegjësit të rojave.<sup>20</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Sipas rregullës 56(5) të Rregullores, paneli mund të caktojë kushte që i gjykon të përshtatshme për lirim, për të garantuar praninë e të paraburgosurit.

9. Sipas nenit 53(1) të Ligjit, të gjitha subjektet dhe personat në Kosovë bashkëpunojnë dhe përmbushin pa vonesë të papërligjur çdo kërkesë për ndihmë ose çdo urdhër apo vendim të lëshuar nga DHS-ja.

---

<sup>14</sup> Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 5-7.

<sup>15</sup> Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 10-11.

<sup>16</sup> Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 12.

<sup>17</sup> Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 14.

<sup>18</sup> KSC-BC-2020-06, F00391, Mbrojtja e z. Veseli, *Kundërpërgjigje Urgjente e Mbrojtjes së Veselit ndaj Parashtrimeve të Administratorës mbi Ndryshimin e Kushteve të Vizitës së Dytë si i Paraburgosur*, 9 korrik 2021, konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>19</sup> Kundërpërgjigjja, para. 1.

<sup>20</sup> Kundërpërgjigjja, para. 2-4.

### III. DISKUTIM

#### A. VIZITA TE VARRI

10. Lidhur me kërkesën e z. Veseli për të vizituar varrin e babait të tij të ndjerë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se në Vendimin për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur ai konstatoi se fakti që babai i Veselit kishte ndërruar jetë përbënte rrethana të jashtëzakonshme dhe arsye humanitare bindëse që arsyetonin lirimin e tij të përkohshëm për të kryer vizitë si i paraburgosur.<sup>21</sup> Ai konstatoi edhe se rituali i mbajtjes së zisë është mjaft i rëndësishëm në besimin dhe traditën e z. Veseli.<sup>22</sup> Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, për shkak të kufizimeve logjistike dhe kohore, z. Veseli nuk pati mundësi të merrte pjesë në varrimin e babait. Duke pasur parasysh rrethanat e mësipërme dhe faktin se vizita tek varri i të ndjerit është element thelbësor i ritualit të mbajtjes së zisë në kontekstin e besimit fetar dhe traditës së zotit Veseli, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton këtë pjesë të kërkesës së z. Veseli.

11. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se kushtet e përcaktuara në Vendimin për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur dhe veçanërisht ato të renditura në paragrafin 15(k) dhe (l) lidhur me ruajtjen e fshehtësisë për praninë e z. Veseli në territorin e Kosovës, do të vazhdojnë të zbatohen. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i vetëdijshëm për faktin se varri ndodhet [REDAKTUAR] dhe kjo mund të tërheqë vëmendjen e mediave [REDAKTUAR]. Për këtë arsye, përveç kushteve të përcaktuara në Vendimin për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron që vizita tek varri të kryhet sipas kushteve të mëposhtme shtesë:

---

<sup>21</sup> Vendimi për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur, para. 12.

<sup>22</sup> Vendimi për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur, para. 12.

- a) koha e vizitës si i paraburgosur brenda periudhës treditore të përcaktohet nga përgjegjësi i rojave, bazuar në vlerësimin e sigurisë të kushteve mbizotëruese dhe nevojave operative;
- b) vizita si i paraburgosur të kufizohet brenda një kohe të caktuar prej 15 minutash, në varësi të vlerësimit të përgjegjësit të rojave;
- c) vizita si i paraburgosur të anulohet ose ndërpritet nëse në kohën e kryerjes së vizitës së propozuar vlerësimi dinamik i sigurisë nga përgjegjësi i rojave tregon se rreziku për incidente është tepër i lartë për t'u pranuar ose zvogëluar.

#### B. ZGJERIMI I RRETHIT TË ANËTARËVE TË FAMILJES SË NGUSHTË

12. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se, në Vendimin për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur, ai autorizoi z. Veseli të largohej nga objekti i sigurt i paraburgimit vetëm [REDAKTUAR] dhe anëtarët e familjes së ngushtë [REDAKTUAR], me miratimin paraprak të përgjegjësit të rojave dhe pas paraqitjes së dëshmisë së identitetit.<sup>23</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej lejoi që z. Veseli të vizitohej në objektin e sigurt të paraburgimit nga anëtarët e familjes së ngushtë, të identifikuar paraprakisht, brenda rrezes së shikimit dhe dëgjimit të përgjegjësit të rojave dhe sipas të gjitha kushteve të tjera që gjykohen të nevojshme.<sup>24</sup>

13. Z. Veseli tani kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të urdhërojë Administratoren të zgjerojë rrethin e anëtarëve të familjes së ngushtë që ai lejohet të takojë [REDAKTUAR] që të përfshijë edhe të afërm të rrethit të dytë siç janë [REDAKTUAR],<sup>25</sup> dhe [REDAKTUAR].<sup>26</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban

---

<sup>23</sup> Vendimi për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur, para. 15(c).

<sup>24</sup> Vendimi për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur, para. 15(f).

<sup>25</sup> Kërkesa, para. 9(a)

<sup>26</sup> Kërkesa, para. 9(b).

parasysh rëndësinë që ka mbështetja e familjes në rast të humbjes së një njeriu të dashur. Megjithatë, ai thekson se ka konstatuar që vizita si i paraburgosur në Kosovë nuk mund të kryhet sipas kushteve që nuk zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet që lidhen me lirimin e përkohshëm të z. Veseli.<sup>27</sup> Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se lejimi i z. Veseli që të takojë një grup të madh personash në të njëjtin vend, përkatësisht [REDAKTUAR]. Për më tepër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se një tubim i tillë i madh personash mund të vërë në rrezik aftësinë për mbikëqyrjen e ndërveprimeve midis pjesëmarrësve dhe të rrisë rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b) të Ligjit. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, për hir të marrëdhënies së tyre të ngushtë me z. Veseli dhe me babain e tij të ndjerë, z. Veseli do të autorizohet të takohet me [REDAKTUAR],<sup>28</sup> [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe në përputhje me të njëjtat kushte të përcaktuara në paragrafin 15(c) të Vendimit për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton këtë pjesë të kërkesës. Për sa u takon të afërmeve të tjerë të rrethit të dytë,<sup>29</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake e sheh të përshtatshme të autorizojë që ata të vizitojnë z. Veseli në objektin e sigurt të paraburgimit, me të njëjtat kushte të përcaktuara në paragrafin 15(f) të Vendimit për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur dhe në varësi të paraqitjes së dokumenteve të tyre të identifikimit përgjegjës të rojave para organizimit të këtyre vizitave. Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron që këto vizita të kryhen me grupe të vogla vizitorësh dhe nën monitorimin nga afër të përgjegjës të rojave, i cili mund të vendosë çfarëdo kushti që e gjykon të nevojshëm, duke pasur veçanërisht parasysh situatën e sigurisë dhe kufizimet operative të misionit.

---

<sup>27</sup> Vendimi për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur, para. 14.

<sup>28</sup> Siç identifikohen në paragrafin 9(a) të Kërkesës dhe në Shtojcën 1 të Kërkesës.

<sup>29</sup> Siç identifikohen në paragrafin 9(b) të Kërkesës dhe në Shtojcën 1 të Kërkesës.

#### IV. VENDIM

##### 14. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **MIRATON** kërkesën e z. Veseli për të vizituar varrin e babait të tij, sipas kushteve të përcaktuara në Vendimin për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur dhe kushteve të tjera të përcaktuara në paragrafin 11 më lart;
- b) **MIRATON** pjesërisht kërkesën e z. Veseli për të zgjeruar listën e anëtarëve të familjes së ngushtë që ai lejohet t'i takojë [REDAKTUAR], që të përfshijë [REDAKTUAR], të identifikuar në paragrafin 9(a) të kërkesës, me të njëjtat kushte të përcaktuara në paragrafin 15(c) të Vendimit për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur;
- c) **AUTORIZON** që z. Veseli të vizitohet në objektin e sigurt të paraburgimit nga të afërmit e tjerë të rrethit të dytë, të identifikuar në paragrafin 9(b) të kërkesës, me të njëjtat kushte të përcaktuara në paragrafin 15(f) të Vendimit për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur e në varësi të paraqitjes së dokumenteve të tyre të identitetit përgjegjës të rojave përpara organizimit të këtyre vizitave dhe sipas kushteve të tjera të përcaktuara në paragrafin 13 më lart;
- d) **I KUJTON** z. Veseli se vazhdojnë të jenë në fuqi kushtet e përcaktuara në Vendimin për Miratimin e Vizitës si i Paraburgosur;
- e) **AUTORIZON** Zyrën Administrative të marrë masa, në bashkëpunim me partnerët e jashtëm, për zbatimin e këtij vendimi;
- f) **AUTORIZON** Zyrën Administrative të njoftojë autoritetet e tjera që konsiderohen të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi;
- g) **I KUJTON** autoriteteve në Kosovë se duhet të zbatojnë pa vonesa të panevojshme çdo vendim të nxjerrë nga DHS-ja ose çdo kërkesë për ndihmë; dhe



- h) **URDHËRON** Mbrojtjen, ZPS-në dhe Zyrën Administrative të dorëzojnë versionet e redaktuara publike përkatësisht të Kërkesës, Përgjigjes dhe Parashtrimeve të Zyrës Administrative, pas kthimit të z. Veseli në shtetin pritës.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatësi Nikola Giju**  
**Gjykatës i Procedurës Paraprake**

E premte, 9 korrik 2021

Në Hagë, Holandë.